Kronikë

Tritoli në vilën e Xhelal Mziut/ Kamerat fiksuan autorin, me kapuç dhe biçikletë! Humb gjurmët te Universiteti Bujqësor

Në pamje ai duket se ka vepruar i vetëm. Kamerat e kanë fiksuar deri në afërsi të Institutit Bujqësor dhe më pas i humbasin gjurmët. Autori ishte veshur me rroba të errëta dhe me kapuç.

Xhelal Mziu dhe vila e tij

Sokol Dema
20 Shtator, 10:37 | **Përditesimi: 20 Shtator, 11:16**

Share

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

TIRANË- Një person me kapuç dhe me biçikletë është filmuar nga kamerat e sigurisë teksa hedh sasinë e tritolit në vilën e deputetit demokrat, Xhelal Mziu. Burime nga grupi hetimor bëjnë me dije për Report Tv se kamerat e sigurisë pranë vilës së Mziut e kanë fiksuar autorin i cili vjen me një biçikletë. Ai ndalon para vilës së deputetit Mziu dhe vendos në pjesën e murit rrethues sasinë e vogël të tritolit. Më pas menjëherë largohet me biçikletë.

Në pamje ai duket se ka vepruar i vetëm. Kamerat e kanë fiksuar deri në afërsi të Universitetit Bujqësor dhe më pas i humbasin gjurmët. Në pamjet e kamerave të sigurisë dallohet se autori ishte i veshur me rroba të errëta dhe me kapuç.

Për ngjarjen, deputeti i Sali Berishës është pyetur sërish nga grupi hetimor, por ai i ka qëndruar së njëjtës dëshmi, duke thënë se nuk ka konflikte me persona të tjerë.



LEXO EDHE:
"Po ua sjellin banorëve shpirtin në majë të hundës"/ Braçe denoncon parkimin ilegal: U rihap dy ditë pasi u mbyll (VIDEO)

Shpërthimi me tritol ndodhi rreth orës 01:00 të 19 shtatorit, duke lënë pas vetëm dëme materiale. Vila 2 katëshe ku banon deputeti i Sali Berishës, është e rrethuar me mur dhe kangjella, territor brenda të cilit ndodhen edhe disa vila të vëllezërve e familjarëve të tij.

Vala goditëse e shpërthimit dëmtoi një prej dritareve të vilës, xhami i së cilës u plasarit.

Pas ngjarjes, Mziu e Sali Berisha dolën në një konferencë për shtyp, ku akuzuan se ngjarja ka prapavijë politike.

Mziu doli deputet nga 11 maji pasi ishte pjesë e listës së sigurt në qarkun Dibër. Gjatë fushatës, ai u përfshi në një incident, ku një zyrtar në Bulqizë e denoncoi në polici për dhunë.

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: Tirane | xhelal mziu | tritol | kamez

Komento

Komente

Artan: 20/09/2025 13:47
Ja vila e nje politikani te vobekte! Edhe presin re dalim te protestojme per keta hajduteri!
Përgjigju

Goni: 20/09/2025 10:52
Shi ca shpie ka! Ku i gjeti leket per ta bere eshte pyetja?! Alo, SPAk aty je?
Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: 20 Shtator, 08:58
Qeveria e re nis punën, besoni se do përmbushë pritshmëritë e qytetarëve?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Edlir Tetova: Egnatia e qetë dhe gati për Tiranën, s'kam presion për të shkuarën
20 Shtator, 14:36

Tiranë/ Kishin mbetur të bllokuar te Ujvara e Shëngjergjit, policia u vjen në ndihmë dy turistëve gjermanë
20 Shtator, 13:46

Shkelën rregullat e qarkullimit, Rrugorja e Tiranës bën bilancin: 169 gjoba për drejtuesit e automjeteve dhe monopatinave
20 Shtator, 12:56

I akuzuar për mashtrim dhe i dënuar me 1 muaj e 10 ditë burg, arrestohet 39-vjeçari në Tiranë
20 Shtator, 12:47

Milinkovic para sfidës me AF Elbasanin: Nuk jemi ende në 70 përqind të formës, besoj te progresi
20 Shtator, 12:02

Transportonte kokainë me makinë, arrestohet 22-vjeçari në autostradën Tiranë-Durrës! Droga do të shitej në 3 zona të kryeqytetit (EMRI+VIDEO)
20 Shtator, 08:53

Vila me palma e Mziut, e deklaroi 5.7 milionë lekë të fituara si emigrant në Greqi dhe nga rrogat
19 Shtator, 16:23

Erion Veliaj kërkon të marrë pjesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të Tiranës: Nëse më shkarkoni, precedent i rrezikshëm për demokracinë (Letra e plotë)
19 Shtator, 15:12

Tritoli në vilën e Xhelal Mziut, Bardhi: Akt kriminal! Institucionet të zbardhin ngjarjen
19 Shtator, 14:40

Tiranë/ Të dielën aktiviteti 'Triathlon', bllokim i disa rrugëve përreth liqenit të Farkës nga ora 08:00 deri në 13:00
19 Shtator, 14:14

Tiranë/ Tentoi të korruptonte administratoren e rezidencës studentore për akomodimin e vajzës, nis hetimi për 61-vjeçarin
19 Shtator, 13:36

Tritoli në vilën e Xhelal Mziut në Kamëz, Berisha: Akt terrorizmi shtetëror, u krye nga bandat! Deputeti: Hakmarrje politike, s'kam konflikte me njeri (VIDEO)
19 Shtator, 13:31

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje